



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 4/2 Prot.

Tiranë, më 22/4 /2011

Lënda: Rekomandim për “**INTERSIG**” sh.a

REKOMANDIM

Mbështetur në Ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr.211, datë 11.09.2008 “Për zgjedhjen e komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe nr 225, datë 13.11.2008 “Për miratimin e strukturës organike dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Zyrës së Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale”, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit, “**INTERSIG**” sh.a ,

KONSTATOVA

Më datë 07.02.2011 nga grupi i inspektimit të Zyrës së Komisionerit është zhvilluar hetimi administrativ pranë kontrolluesit, “**INTERSIG**” sh.a , me cilësinë si kontrollues që mbledh dhe përpunon të dhëna personale në ushtrim të qëllimit dhe aktivitetit të tij, me objekt:

- Mbrojtja e të dhënave personale, kriteret ligjore për përpunimin, përpunimi i të dhënave sensitive të parashikuara në nenet 5,6,7 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.
- Transferimi ndërkombëtar i të dhënave parashikuar në nenet 8,9 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” .
- Zbatimi i të drejtave të subjekteve të të dhënave personale.
- Siguria e të dhënave personale, kategoria e mjeteve të përpunimit që përdoren, masat për sigurinë e të dhënave personale (neni 27)
- Plotësimi i detyrimit për njoftim (neni 21).

